



NEWCO FERRONIKELI COMPLEX L.L.C.

Part of BALFIN, Balkan Finance Investment Group

NJOFTIM PUNE

Balfin Group është një ndër grupet private investuese më të mëdha në Shqipëri dhe rajon, i pranishëm me aktivitetet për zhvillimin e pasurive të paluajtshme, shitjet me pakicë, ofrimin e shërbimeve dhe menaxhimin e hapsirave tregtare apo industriale, telekomunikacion, industria minerare, financime dhe programe besimi për konsumatorët.

NewCo Ferronikeli Complex L.L.C është pjesë e Balfin Group dhe operon në sektorin e Industrisë së Minierave.

Pozicioni: Inxhinier për Mirëmbajtjen e Makinerive të Rënda

Departamenti: Mirëmbajtje

Lokacioni: Drenas, Kosovë

Detyrat dhe përgjegjësitë:

- Është person përgjegjës për organizimin dhe mbarëvajtjen e punës në garazhen e kompanisë
- Mbikqyr procesin e mirëmbajtjes së rregullt, parandaluese si dhe riparime të prishjeve, që të kryhen me cilësi të lartë brenda objektivave dhe afateve kohore
- Kryen inspektim të rregullt të makinerive të rënda dhe pajisjeve të tjera lidhur me performancën e tyre, gjetjen e gabimeve dhe eliminimin e tyre si dhe testimin e pajisjeve të riparuar
- Koordinon punët rreth riparimeve të makinerisë së rëndë, identifikon mosfunksionimin e tyre dhe planifikon furnizimin me pjesë rezervë për këto makineri
- Sigurohet që të gjitha makineritë e e rënda dhe pajisjet e garazhes trajtohen si duhet duke ushtruar kujdes dhe kontroll të duhur
- Kryen dhe detyra të ngjashme sipas nevojave të kompanisë

Kualifikimet dhe Aftësitë:

- Fakulteti I Inxhinierisë Mekanike
- Eksperienca të mëparshme në pozicione të ngjashme në sektoret e riparimit të makinerive të rënda janë të preferueshme
- Çertifikim për servisimin e makinerive të rënda
- Njohuri të specializuara në riparimin dhe mirëmbajtjen e makinerive të rënda
- Të ketë njohuri shumë të mira kompjuterike (Microsoft office)
- Aftësi të mira menaxhuese, komunikuese dhe organizative
- Aftësi për t'u përshtatur në punën në grup

Kushte e punës:

NewCo Ferronikeli Complex L.L.C ofron paketë të mirë kompesimi dhe benefitesh, përfshirë edhe bonuse bazuar në meritë dhe vlerësimin e performancës.

Mënyra e aplikimit:

Kandidatët e interesuar janë të lutur të dërgojnë CV-të e tyre së bashku me letër motivimi dhe dokumentet përcjellëse më së largu deri me **20/02/2020**, në adresën e e-mailit hr@ferronikeli.com duke përcaktuar në subjekt pozicionin **"Inxhinier për Mirëmbajtjen e Makinerive të Rënda"**

*Të gjitha aplikimet do të trajtohen me konfidencialitet të plotë dhe vetëm kandidatët që do të përzgjedhen në listen e ngushtë do të kontaktohen.



Besim Mala Street no.227, 13000 Gllgoc, Republic of Kosovo, Phone: + 383 (0)38 585 000, Fax: + 383 (0) 38 585 109

NEWCO FERRONIKELI COMPLEX L.L.C. is part of BALFIN, Balkan Finance Investment Group

